VENDIM
Nr. 4, datë 30.3.2020

PËR TRAJTIMIN E PËRKOHSHËM FINANCIAR MUJOR TË DISA FUNKSIONARËVE DHE NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, GJATË PERIUDHËS SË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 30.3.2020,

VENDOSI:

1.. Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se tre muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.

2. Nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, të bordeve apo të komisioneve të institucioneve të administratës shtetërore, të institucioneve publike të arsimit të lartë, të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por jo më shumë se tre muaj, nuk e përfitojnë shpërblimin mujor përkatës.

3. Përjashtohen nga zbatimi i pikës 2, të këtij vendimi, nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, bordeve apo komisioneve të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Në kuptim të këtij vendimi, institucione të administratës shtetërore janë ato të përcaktuara sipas ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

5. Institucionet përkatëse, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, të derdhin shumat e papaguara në buxhetin e shtetit, në fondin antiCOVID-19, të miratuar për vitin 2020, në bankën e nivelit të dytë Credins Bank, me numër llogarie në lekë nr.1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.

6. Miratimin, në parim, të projektvendimit të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19" të propozuar nga ministri i Shtetit për Rindërtimin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen Kryeministria, aparatet e ministrive, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital mbi 50% shtetëror si dhe institucionet e administratës shtetërore, të cilat, sipas legjislacionit të tyre specifik, kanë këshilla apo borde drejtuese me të drejtë pagese, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.____, datë _____

PËR TRAJTIMIN E PËRKOHSHËM FINANCIAR MUJOR TË DISA FUNKSIONARËVE DHE NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, GJATË PERIUDHËS SË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se tre muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.
2. Nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, të bordeve apo të komisioneve të institucioneve të administratës shtetërore, të institucioneve publike të arsimit të lartë, të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por jo më shumë se tre muaj, nuk e përfitojnë shpërblimin mujor përkatës.
3. Përjashtohen nga zbatimi i pikës 2, të këtij vendimi, nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore të cilët janë anëtarë të këshillave, bordeve apo komisioneve të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
4. Në kuptim të këtij vendimi, institucione të administratës shtetërore janë ato të përcaktuara sipas ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
5. Institucionet përkatëse, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, të derdhin shumat e papaguara në buxhetin e shtetit, në fondin antiCOVID-19, të miratuar për vitin 2020, në bankën e nivelit të dytë Credins Bank, me numër llogarie në lekë nr.1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.
6. Ngarkohen Kryeministria, aparatet e ministrive, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital mbi 50% shtetëror si dhe institucionet e administratës shtetërore, të cilat, sipas legjislacionit të tyre specifik, kanë këshilla apo borde drejtuese me të drejtë pagese, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama